



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.704/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Hidroing -DK"- Prishtinë, kundër njoftimit për Konkursin e Projektimit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës së Ish-Kadastrit-Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-4389-2-231, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Prishtinë, më datë: 27.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Hidroing -DK"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës së Ish-Kadastrit-Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-4389-2-231, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

II. ANULOHET, njoftimi për Konkursin e Projektimit me titull: "Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës së Ish-Kadastrit-Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-4389-2-231, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Hidroing -DK"- Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:18.06.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:30.07.2018, ku kanë marrë pjesëtri(3) operator ekonomik.

Kundër njoftimit për Konkursin e Projektimit operatori ekonomik: "Hidroing -DK"- Prishtinë, me dt: 09.11.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 21.11.2018,Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik:"Hidroing -DK"- Prishtinë,si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues:"Hidroing -DK"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 30Nëntor 2018, me nr.704/18, kundër njoftimit për Konkursin e Projektimit me titull: "Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës së Ish-Kadastrit-Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-4389-2-231, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës,duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 80,të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41.3, të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.12.2018,ka autorizuar ekspertinshqyrtues-profesional, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.Ekspertishqyrtues në raportin e dt: 13.12.2018, sqaron:

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me këtë lëndë kemi një ankese dhe një vendim të OSHP-së me nr.465/18 dt.23.10.2018, ku gjatë trajtimit të ankesës nr 465/18 janë caktuar dy ekspert të prokurimit (ekspert profesional dhe ekspert teknik). Në ankesën nr.704/18 të datës 30.11.2018-OE ankuese me kod-nr.2607 thekson se AK e ka vlerësuar me pikë maksimale OE-në me kod-nr. 1209 lidhur me kriterin vlerësues-kriterin hapësinor. Sipas OE-së ankuese me kod-nr. 2607, OE me kod-nr. 1209 nuk i'u ka përmbajtur detyrës projektuese, pra nuk merret fare me trajtimin e objekteve përreth dhe tersive të tjera urbane, eksperti shqyrtues konstaton se lidhur me këtë pretendim është nxjerrë një vendim i OSHP-së (vendimi me nr. PSH.465/18 dt 23.10.2018) ku sipas këtij vendimi vërtetohet se OE me kod-nr. 1209 nuk e trajton Konceptin hapësinor të zgjidhjes (trajtimin e objekteve për rreth dhe të risive tjera urbane).

OE ankuese me kod.2607 thekson se OE- me kod 1209 në paragrafin 5/ pika 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NDERTES, e përshkruan parterin e ngushte të hyrjes në objekt por jo edhe atë të afërm apo me të gjerë, pra nuk merret as me kiosqet as me gjelbërim dhe rregullimin e hapësirës për rreth që është kërkesë kryesore e detyrës projektuese. Eksperti shqyrtues konstaton se edhe me këtë pretendim kemi vendimin e OSHP-së (vendimi me nr. PSH.465/18 dt 23.10.2018) ku sipas këtij vendimi vërtetohet se OE me kod. 2609 ka të drejtë, se në detyrën projektuese tek në 5.3 KERKESAT TJERA / PERMBAJTJA E PROJEKTIT Pika 5. Zgjidhja urbanistiko-arkitektonike e kompleksit me parter, na udhëzon se duhet trajtuar edhe zonën rreth objektit në fjalë.

OE me kod-nr.2609 pretendon se OE me kod-nr 1209, në paragrafin 5-PERSHKRIMI I PROJEKT PROPOZIMIT, në pikën 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NDERTESE, parasheh 11 parkingje në bërthamat e dy ndërtesave historike, pa bërë analize se si do të ndikoj parkingu në lokacionin dhe në hapësirën e gjelbëruar publikuese dhe nuk e prefill largimin e parkingjeve e që është kërkesë e detyrës projektuese. Eksperti shqyrtues konstaton se në vendimin e OSHP-se nr 465/18 vërtetohet se projekti me kod-nr.1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastrit për ballë shkollës së parë shqipe-me afër rrethit ekzistues. Sipas vendimit të OSHP-se nr. 465/18, kjo zhvendosje, jo që nuk ofron zgjidhjen e kërkuar nga komuna, por ngarkon edhe me shumë komunikacionin duke shkaktuar kaos në rrethin ekzistues dhe degradon objektin fqinje-Shkollën e parë Shqipe në Prishtinë.(shiko 1209, pjesa grafike: Baza Përdhese). Andaj pala me kod-nr.2609 ka të drejtë. Në kërkesën 5. Detyrën Projektuese /5.2 Kërkesat Kryesore/Qasja ceket "Për shkak të mungesës së hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku tjetër, mundësisht afër zonës historike në qytet"

OE me kod-nr.2609 pretendon se Projekti me kod-nr.1209, i mungojnë detajet që janë kërkuar në pikën 9 Detajet karakteristike arkitektonike të Përmbajtjes së projektit. Gjithashtu Projekti nr.1209 nuk ka prezantuar

as rrethinat e ndërtesës që është kërkuar në piken 10-Perspektiva e ndërtesës me rrethine. Ju mungon kërkesa nr.11 Fotografi – perspektiva të enterierit të propozuar me detaje. Gjithashtu mungon edhe pika 12 e Përmbajtjes së Projektit:Paramasa dhe Parallogaria për implementimin e punëve me specifikimin e materialeve dhe tekniken e punimeve.Eksperti shqyrtues konstaton se edhe ky pretendim është i përsëritur sikur në ankesën nr 465/18, dhe përkëtë pretendim kemi njëvendim të OSHP-së (vendimi 465/18), ku sipas këtij vendimi OSHP deklaron se edhe ky pretendim i OE-së ankuese me kod-nr.2609 është i bazuar

OE me kod-nr.2609 pretendon se Projekti me kod-nr.1209 nuk e arsyeton ekonomikisht e as funksionalisht ndryshimin e vertikaleve të tualeteve duke shkaktuar kosto shtese të pa nevojshme. Shikovizatimin 04,Baza Katit.

Eksperti shqyrtues deklaron se edhe përkëtë pretendim, OSHP në vendimin nr 465/18 e cilëson si pretendim pjesërisht i bazuar, dhe AK-konkretisht komisioni i rivlerësimit nuk ka marrë asnjë veprim për ta vërtetuar (dëshmuar) të kundërtën.

OE me kod-nr.2609 pretendon se Projekti me kod-nr.1209 në paragrafin 5-PERSHKRIMI I PROJEKT PROPOZIMIT,në piken 1.2 PARTERI DHE QASJA NË NDERTESE parasheh 11 parkingje në bërthama të dy ndërtesave historike pa bërë analize se si do të ndikoj parkingu në lokacion dhe në hapësirën e gjelbëruar publike si dhe nuk e prefill largimin e parkingjeve që është kërkesë edhe e detyrës projektuese.Projekti Nr.1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ishKadastrit përball Shkollës së Pare Shqipe dhe ngarkon edhe me shumë komunikacionin në tërësi duke shkaktuar kaos në rrethin ekzistues.Eksperti shqyrtues konstaton se edhe ky pretendim është i përsëritur sikur në ankesën nr 465/18, dhe për këtë pretendim kemi një vendim të OSHP-së (vendimi 465/18), ku sipas këtij vendimi OSHP deklaron se edhe ky pretendim i OE-së ankuese me kod-nr.2609 është i bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se të njëjtat pretendime ankimore janë trajtuar në raportin nr.465/18 nga ekspertet paraprak, (ekspertja teknike dhe eksperti profesional i Prokurimit)si dhe të njëjtat pretendime janë vendosur-gjykuar me vendimin e OSHP-së PSH.nr.465/18 dt.23.10.2018.

Ndërsa duke u bazuar në dokumentacionin që e posedon eksperti shqyrtues, AK rrespektivisht komisioni i rivlerësimit në bazë të raportit të këtij komisioni rivlerësues eksperti shqyrtues nuk hasë asnjë veprim i cili do ta vërtetonte të kundërtën e asaj çka është trajtuar-vendosur në vendimin e OSHP-së nr.465/18.

Mbi këtë bazë ekspertit shqyrtues konstaton se AK-KK-Prishtinë nuk ka zbatuar në tërësi vendimin e OSHP-së nr. 465/18 me rastin e rivlerësimit të ofertave.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Hidroing -DK" shpk-Prishtinë, të aprovohet e bazuar (për arsyet që u cekën në pretendimet e lartëshënuara), të anulohet Njoftimi për rezultatet e konkursit të projektimit-rezultatet e vlerësimit artistik, dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues – KK-Prishtinë, me datë: 13.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: "Hidroing -DK"- Prishtinë, me datë: 13.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, sepajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 27.12.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, ekspertit shqyrtues-profesional OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues znj. Morina deklaroj: Pajtohem me vendimin e ekspertit sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit për mua është e pa qarte se si vlerësohet me piket maksimale në të cilën OSHP me vendim konstaton që ka shkelje të detyrës projektuese rrjedhimisht të neneve dhe LPP-se pra dilema me e madhe në ankese duhet të merr përgjigje si OSHP se si duhet vepruar një AK dhe ju të konstatoni që OE i prezantuar me kodin përkatës nuk ka respektuar detyrën projektuese kërkesë kjo që del nga LPP dhe rregullorja për udhëzues operativ, AK ka vazhduar me piket maksimale OE që nuk e zbatuar detyrën, në si OE kemi humbur një kontratë kurse e kemi respektuar detyrën projektuese OSHP duhet të jep një udhëzim se si AK të veproj me OE. Ne vazhdim OE ankues deklaroj që në një pikë bie ndesh me jurinë profesionale të AK kriteri 1. Ku përfshihen konceptin hapësinor, raportin në mes të terezisë hapësinore. Në si OE marrim pikë minimale ku thuhet se kriteri hapësinor tejkalon kufinjet e parcelës. Ne jemi të obliguar që të ruhen trashëgimia kulturore pra kërkesa e AK-se bie ndesh dhe është kundër thënës. Kërkoj nga ju një rekomandim për AK dhe kërkoj që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-z. Sallahu deklaroj: Mbështesim vendimin e AK-se për shkak se kemi caktuar ekspert të arkitekturës dhe kanë vlerësuar duke ia ngritur poenët OE ankimore por ka ritheksuar se ofertat me kod 2607 dhe oferta 1209 të kualifikohen në dy kriterë: 1. Kriteri hapësinor 2607 tejkalon zonën e përcaktuar hapësinore 2. Kriteri ofron zgjidhje më të mira programore me të mira me detyrë projektuese në këtë rast AK e mbështet juridikisht procesin nuk ka përfunduar po ashtu AK ka respektuar edhe vendimin e OSHP-se, por në disa pika të vendimit ka kontestuar vendimin e OSHP-se. Kërkoj të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti shqyrtues z.Sopi deklaroj: Kemi një vendim paraprak 465/18 23.10.2018, ku ishin të caktuar 2 ekspert. Sipas gjendjes faktike kam vërejtur se AK nuk respekton vendimin e OSHP-se. Andaj jam ardhur në përfundim sa i përket të njëjtave pretendime është ankuar OE ankues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se sqaron se lidhur me këtë lëndë kemi vendimin e OSHP-së me nr.465/18 dt.23.10.2018.

Sa i përket pretendimit të OE ankuese me kod.2609 thekson se OE- me kod 1209 në paragrafin 5/ pika 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NDERTES, e përshkruan parterin e ngushtë të hyrjes në objekt por jo edhe atë të afërm apo me të gjerë, pra nuk merret as me kiosqet as me gjelbërim dhe rregullimin e hapësirës për rreth që është kërkesë kryesore e detyrës projektuese. Paneli shqyrtues konstaton se me këtë pretendim kemi vendimin e OSHP-së (vendimi me nr. PSH.465/18 dt 23.10.2018) ku sipas këtij vendimi vërtetohet se OE me kod. 2609 ka të drejtë, se në detyrën projektuese tek në 5.3 KERKESAT TJERA / PERMBAJTJA E PROJEKTIT Pika 5. Zgjidhja urbanistiko-arkitektonike e kompleksit me parter, na udhëzon se duhet trajtuar edhe zonën rreth objektit në fjalë.

Sa i përket pretendimit të OE ankuese me kod-nr.2609 pretendon se OE me kod-nr 1209, në paragrafin 5- PERSHKRIMI I PROJEKT PROPOZIMIT, në pikën 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NDERTESE, parasheh 11 parkingje në bërthamat e dy ndërtesave historike, pa bërë analizë se si do të ndikoj parkingu në lokacionin dhe në hapësirën e gjelbëruar publikuese dhe nuk e prefill largimin e parkingjeve që është kërkesë e detyrës projektuese. Paneli shqyrtues konstaton se në vendimin e OSHP-se nr 465/18 vërtetohet se projekti me kod-nr.1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastrit për ballë shkollës së parë shqipe-me afër rrethit ekzistues. Sipas vendimit të OSHP-se nr. 465/18, kjo zhvendosje, jo që nuk ofron zgjidhjen e kërkuar nga komuna, por ngarkon edhe me shumë komunikacionin duke shkaktuar kaos në

rrethin ekzistues dhe degradon objektin fqinje-Shkollën e pare Shqipe ne Prishtine.(shiko 1209, pjesa grafike: Baza Përdheses). Andaj pala me kod-nr.2609 ka te drejte. Ne kërkesën 5. Detyrën Projektuese /5.2 Kërkesat Kryesore/Qasja ceket “Për shkak te mungesës se hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku tjetër, mundësisht afër zonës historike ne qytet”

Sa i përket pretendimit te OE ankuese me kod-nr.2609 pretendon se Projekti me kod-nr.1209, i mungojnë detajet qe janë kërkuar ne piken 9 Detajet karakteristike arkitektonike te Përmbajtjes se projektit. Gjithashtu Projekti nr.1209 nuk ka prezantuar as rrethinat e ndërtesës qe është kërkuar ne piken 10-Perspektiva e ndërtesës me rrethine. Ju mungon kërkesa nr.11 Fotografi – perspektiva te enterierit te propozuar me detaje. Gjithashtu mungon edhe pika 12 e Përmbajtjes se Projektit:Paramasa dhe Parallogaria për implementimin e punëve me specifikimin e materialeve dhe tekniken e punimeve.Paneli shqyrtues

Mbi këtë bazë Paneli shqyrtues konstaton se AK-KK-Prishtinë nuk ka zbatuar në tërësi vendimin e OSHP-së nr. 465/18 me rastin e rivlerësimit të ofertave, dhe se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat